REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT**
**DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE VLORË**
**SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Nr.660 prot.

Vlorë, më 02.11.2026

## SHPALLJE VENDI VAKANT

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, si dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr. 163, datë 28.08.2024 "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore*", Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë shpall konkursin për pozicionin e punës:

**PUNËTOR MIRËMBAJTJE NË SEKTORIN E ARKEOLOGJISË, ARKITEKTURËS, ARTIT DHE MENAXHIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

**Kategoria e pagës, KLASA III**

Përshkrimi i përgjithshëm i punës, për pozicionin si më sipër, është:

- Pozicioni i punës është në Kalanë e Kaninës, në Sektorin e Arkeologjisë, Arkitekturës, Artit dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore , pranë DRTK- Vlorë;
- Realizimi i punimeve koherente në Kalanë e Kaninës, si:, heqje vegjetacioni, pastrime, punë mirëmbajtëse etj.., **si dhe shitje biletash turistëve të huaj dhe vendas në monumentet e kulturës Kalaja e Kaninës.**

**Kriteret e përgjithshme:**

- Të ketë përfunduar arsimin e mesëm (preferohet arsimi i lartë) ;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi;
- Të mos jetë në ndjekje penale nga ana e organeve të prokurorisë apo gjykatës;
- Të komunikoj në gjuhën Angleze **(+njohja e gjuhëve të tjera përbën përparësi në përzgjedhje)**;
- Të jetë i aftë për punë (raport për aftësi në punë);
- Të jetë banor i fshatit Kaninë, Bashkia Vlorë.

Adresa: Lagja 'Hajro Çakërri', Rruga 'Sulejman Delvina', Nr.56 Vlorë
Tel/Fax: 0035533430665
e-mail: drkkvlore@yahoo.com

**Kriteret e veçanta:**

Kandidatët duhet të dorëzojnë dorazi ose në rrugë postare, pranë Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë, dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Kerkesë për punësim për pozicionin e punës;
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës së arsimit të mesëm e njehsuar me origjinalin( preferohet arsimi i lartë) **fotokopje e diplomës së arsimit të lartë e njehsuar me origjinalin, nëse ka përfunduar studimet e arsimit të lartë);**
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës;
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti);
- Fotokopje e letërnjoftimit.

*Dokumentacioni i kërkuar, të dorëzohet në zyrën e protokollit të D.R.T.K – Vlorë, gjatë ditëve zyrtare të punës,* ***nga dita e Hënë deri ditën e Enjte, ora 8:00 – 16:30, si dhe ditën e Premte, ora 8:00 - 14:00.***

***Afati i fundit i dorëzimit të dokumentacionit, do të jetë ditën e Premte, datë, 13.11.2026 ora 14:00.***

Ky njoftim për shpallje, i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik për publikim.

**DREJTOR**

**Orgest FEIMI**

Adresa: Lagja 'Hajro Çakërri', Rruga 'Sulejman Delvina', Nr.56 Vlorë
Tel/Fax: 0035533430665
e-mail: drkkvlore@yahoo.com